

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

**“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE AFATEVE
PËR ZBATIMIN E GRUMBULLIMIT TË DIFERENCUAR TË
MBETJEVE PËR TË GJITHA RRYMAT E MBETJEVE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Projektvendimi synon të krijojë një kuadër ligjor të qartë, të detajuar dhe të zbatueshëm për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Ky akt nënligjor hartohet në përputhje me autorizimin ligjor sipas pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Nëpërmjet këtij akti rregullator përcaktohen kriteret, procedurat dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese mbrojtjes ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit dhe të mbrojtjes së shëndetit të njeriut, me qëllim reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohen, rritjen e nivelit të riciklimit dhe rikuperimit, si dhe parandalimin e ndikimeve negative në mjedis.

Objektivi i këtij akti është sigurimi i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim, promovimi i ripërdorimit, riciklimit, parandalimi i përzierjes së mbetjeve, si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TE TJERA POLITIKE**

Ky projektakt është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakeve (PPAP) të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2026 dhe vjen në zbatim të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve” përbën një ndërhyrje të domosdoshme në kuadrin ligjor, duke synuar ngritjen e një sistemi për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve sa më të qartë, të strukturuar dhe të zbatueshëm në praktikë. Ky projektvendim kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave mjedisore kombëtare, si dhe shërben si instrument i nevojshëm për mbrojtjen e interesit publik dhe për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm, transparent dhe efikas të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në Shqipëri.

Projektvendimi u hartua fillimisht mbi bazën e rregullimit të mbetjeve bashkiake, sipas përcaktimit të pikës 21, të nenit 4, të ligjit 57/2025. Megjithatë, në vijim të vlerësimeve dhe rekomandimeve të Ministrisë së Drejtësisë, projektvendimi është rishikuar në tërësi me qëllim sigurimin e përputhjes së plotë me autorizimin ligjor të parashikuar në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, i cili parashikon miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve. Njëkohësisht, nëpërmjet këtij projektvendimi konsiderohet i ezauruar edhe autorizimi i parashikuar në pikën 5 të nenit 47 të ligjit nr. 57/2025, çka përjashton nevojën për miratimin e një akti të veçantë në zbatim të kësaj dispozite.

Projektvendimi u ripunua në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët kanë kontribuar përmes sugjerimeve të përcjella si në rrugë elektronike, ashtu edhe gjatë konsultimeve të drejtpërdrejta.

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i kriterëve, procedurave dhe afateve për organizimin e grumbullimit të diferencuar për rrymat e mbetjeve, përfshirë: vajrat e përdorura, mbetjet bio, ambalazhet dhe mbetjet e tyre, produktet plastike njëpërdorimshe, bateritë dhe mbetjeve të baterive, automjetet në fund të jetës, mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbetjet nga ndërtimi dhe shembja, mbetjet nga anijet dhe nga ngarkesat, mbetjet nga gomat e përdorura dhe rrymave të tjera të mbetjeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

Nga fusha e zbatimit të këtij projektvendimi përjashtohen ndotësit organikë të qëndrueshëm dhe mbetjet e industrisë së dioksidit të titanit, për shkak se këto kategori mbetjesh i nënshtrohen proceseve të depozitimit për asgjësim dhe nuk grumbullohen në mënyrë të diferencuar. Po kështu, mbetjet spitalore rregullohen nga Vendimi nr. 232, datë 1.4.2026, “Për miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për menaxhimin e mbetjeve spitalore”, ndërsa mbetjet nga nënproduktet shtazore trajtohen nga legjislacioni i posaçëm përkatës.

Projektvendimi përbën një komponent thelbësor i përpjekjeve për forcimin e mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë shëndetësore në vend, si dhe për përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përfshirë këtu edhe direktivën 2008/98/KE “Për mbetjet”.

Zbatimi i dispozitave të këtij akti pritet të sjellë përmirësime të drejtpërdrejta në organizimin dhe funksionimin e sistemit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, duke garantuar parandalimin e përzierjes së tyre, reduktimin e ndotjes mjedisore dhe rritjen shkallës së rikuperimit dhe riciklimit të materialeve.

Gjithashtu, projektvendimi parashikohet të ketë efekte pozitive ekonomike dhe sociale, përmes optimizimit të kostove, zhvillimit të sektorit të riciklimit, krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjes së ndërgjegjësimit për ndarjen e mbetjeve në burim.

Në këtë kontekst, projektvendimi përbën një instrument të rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike vendore dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, i cili është thelbësor për zbatimin efektiv të standardeve të reja dhe për arritjen e objektivave afatgjata në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 11 dhe të pikës 5, të nenit 47 të Ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim është në harmonizim me kërkesat e ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe synon të përafrojë plotësisht pikën 2, të nenit 10, paragrafin 2, të pikës 1, të nenit 11, dhe paragrafin 3, të pikës 2, të nenit 11, të direktivës 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”, e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është organizuar në 5 Krerë, të cilat parashikojnë dispozitat e përgjithshme, kriteret, procedurat, afatet për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, dispozitat e fundit dhe 2 Shtojca, të cilat parashikojnë sistemin e ngjyrave për grumbullimin e diferencuar dhe kalendarin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.

Kreu i parë përcakton dispozitat e përgjithshme duke saktësuar objektin e vendimit, që konsiston në vendosjen e kriterëve, procedurave dhe afateve për grumbullimin e diferencuar për të gjitha rrymave të mbetjeve, me synim nxitjen e ripërdorimit, riciklimit dhe proceseve të tjera të rikuperimit. Në këtë kre, parashikohen edhe parimet bazë të zbatimit të sistemit, si parandalimi i përzierjes së mbetjeve, mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, si dhe respektimi i hierarkisë së mbetjeve.

Kreu i dytë trajton kriteret e përgjithshme për organizimin e infrastrukturës dhe pikave të grumbullimit, si dhe kriteret specifike për grumbullimin e diferencuar për mbetjet e vajrave të përdorur, mbetjet bio, ambalazhet dhe mbetjet e tyre, mbetjet nga produktet plastike njëpërdorimshme, bateritë dhe mbetjet e tyre, automjetet në fund të jetës, pajisjet elektrike dhe elektronike, mbetjet nga ndërtimi dhe shembja, mbetjet nga anijet dhe ngarkesat e tyre, mbetjet nga gomat e përdorura si dhe mbetjet për rrymat e tjera që nuk janë ambalazhe si letër, karton, qelq, metale, plastikë, tekstile, mbetje shtëpiake të përziara, mbetje shtëpiake të rrezikshme, si dhe mbetje të vëllimshme, me qëllim garantimin e një sistemi funksional, të sigurt dhe të standardizuar, i cili mundëson ndarjen në burim të mbetjeve dhe grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, duke ruajtur cilësinë e materialeve.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

Kreu i tretë trajton procedurat e përgjithshme dhe procedurat specifike për grumbullimin e diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve, duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve përkatës, përfshirë zotëruesin e mbetjeve, bashkisë, autoritetin portual dhe operatorin e licencuar duke siguruar funksionimin e një sistemi të strukturuar për marrjen, transportin dhe dorëzimin e mbetjeve për trajtim të mëtejshëm.

Në kreun e katërt parashikohen afatet për përcaktimin dhe ngritjen e pikave të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve nga bashkitë, si dhe afatet për grumbullimin e diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmirësim të sistemit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.

Në kreun e pestë, parashikohen dispozitat e fundit, ku janë përcaktuar institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

Shtojca 1 parashikon sistemin e ngjyrave për kontejnerëve, qeseve apo pajisjeve për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve si letër, karton, qelq, metale, plastikë, tekstile dhe mbetje shtëpiake të përziera.

Shtojca 2 parashikon përmbajtjen e kalendarit për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve si letër, karton, qelq, metale, plastikë, tekstile dhe mbetje shtëpiake të përziera i cili plotësohet dhe përditësohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, autoritetet portuale, zotëruesit, operatorët e licencuar.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga strukturat përgjegjëse në ministri dhe është konsultuar me ekspertët e GIZ, në kuadër të projektit “BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjelbër” .

Duke qenë se ky projektakt parashikon marrjen e masave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në funksion të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, si

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

dhe në zbatim edhe të autorizimit ligjor, është dërguar në rrugë elektronike, në datë 8.02.2026, për konsultim paraprak në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në vijim të këtij komunikimin, disa nga bashkitë kanë dërguar sugjerime, si më poshtë vijon:

Bashkia Berat u shpreh konform projektvendimit, pa komente apo sugjerime.

Bashkia Tiranë është shprehur si më poshtë vijon:

Lidhur me sugjerimin për përfshirjen e një neni që përcakton se tarifatat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve miratohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pushtetin vendor dhe financat vendore, argumentojmë se projektvendimi ka si objekt përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, në zbatim të ligjit 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe detyrimeve që rrjedhin nga përafrimi me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet” e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Si pasojë ky projektvendim nuk rregullon strukturën tarifore të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që draft-vendimi të përfshijë një dispozitë të qartë mbi rolin operacional të njërive të vetëqeverisjes vendore në zbatimin e grumbullimit të diferencuar, duke përcaktuar detyrimin për hartimin e planeve lokale të ndarjes në burim, organizimin e shërbimit dhe pilotimin gradual të skemave sipas zonave urbane dhe rurale, sqarojmë se në kreun III janë parashikuar procedurat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, ku është qartësuar dhe roli i njërive të vetëqeverisjes vendore, në kreun IV është parashikuar afati për përcaktimin dhe ngritjen e pikave të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe në Shtojcën 2 është parashikuar kalendari i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve që plotësohet dhe përditësohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Lidhur me sugjerimin që të parashikohet se faza e parë e zbatimit të grumbullimit të diferencuar të fokusohet në ndarjen e mbetjeve organike nga ato të riciklueshme, si një hap bazë dhe i zbatueshëm në shkallë kombëtare. Në vijim, sistemi të evoluojë drejt ndarjes më të detajuar sipas rrymave specifike, në përputhje me objektivat e përcaktuara, sqarojmë se janë vendosur afatet për grumbullimin e diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

Lidhur me sugjerimin që të plotësohet me standardizimin e formës dhe karakteristikave teknike të kontejnerëve, veçanërisht për mbetjet organike, sqarojmë se janë parashikuar kriteret për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në Kreun II.

Lidhur me sugjerimin që në kriteret të parashikohet një frekuencë minimale e detyrueshme për pastrimin dhe dezinfektimin e kontejnerëve, duke rritur përgjegjësinë e operatorëve të shërbimit, sqarojmë se parashikimi i frekuencës për pastrim dhe dezinfektim të kontejnerëve vendoset nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Lidhur me sugjerimin që të parashikohet mundësia e përdorimit të kontejnerëve të pajisur me sensorë për monitorimin e nivelit të mbushjes, si pjesë e modernizimit të sistemit të grumbullimit të mbetjeve, sqarojmë se në projektvendim nuk është ndaluar përdorimi i këtyre kontejnerëve.

Lidhur me sugjerimin që të saktësohet përdorimi i koncepteve “Krijuesit e mbetjeve” dhe “zotëruesit e mbetjeve” ose referimi i qartë në përkufizimet përkatëse të ligjit në fuqi, me qëllim shmangien e paqartësive në interpretim dhe zbatim, sqarojmë se përkufizimi i këtyre koncepteve është parashikuar në ligjin nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Lidhur me sugjerimin që afati i raportimit nga operatorët të përcaktohet brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, në mënyrë që të garantohet kohë e mjaftueshme për përpunimin dhe konsolidimin e të dhënave, si dhe rekomandohet gjithashtu parashikimi i një formati standard raportimi periodik, i cili mund të jetë në formë dixhitale ose shkresore, sqarojmë se në projektvendimin e ripunuar janë hequr procedurat e raportimit, duke qenë se në bazë të autorizimit ligjor të projektvendimit parashikohen vetëm procedurat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Afatet për raportimin janë parashikuar në legjislacionin e posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që raportimi periodik të shoqërohet me përcaktimin e indikatorëve të qartë të performancës, mbi bazën e të cilëve të realizohet monitorimi i zbatimit të sistemit, sqarojmë se përcaktimi i indikatorëve të qartë të performancës nuk është objekt i këtij projektvendimi, sqarojmë se në

projektvendimin e ripunuar janë hequr procedurat e raportimit, duke qenë se në bazë të autorizimit ligjor të projektvendimit parashikohen vetëm procedurat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që të parashikohen edhe faza ose objektiva ndërmjetëse për njësitë e vetëqeverisjes vendore (p.sh. për vitet 2027 dhe 2028), me qëllim ndjekjen progresive të realizimit të tyre), sqarojmë se është rishikuar kreu IV dhe janë përcaktuar afatet për grumbullimin e diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që në dispozitat përfundimtare të parashikohet në mënyrë të shprehur një mekanizëm bashkëpunimi të vazhdueshëm ndërmjet Agjencisë dhe njësite të vetëqeverisjes vendore, në funksion të realizimit efektiv të ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor në komunitet, sqarojmë se parashikimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve nuk është objekt i këtij vendimi.

Bashkia Krujë është shprehur si më poshtë vijon:

Lidhur me sugjerimin për rishikimin e afateve dhe vendosja e fazave tranzitore, sqarojmë se është rishikuar kreu IV, ku janë vendosur afatet për të gjitha rrymat e mbetjeve, në përputhje me kërkesat dhe standardet evropiane, si dhe periudhat tranzitore të kërkuara nga qeveria shqiptare, në mënyrë të tillë që të mundësojnë zbatim gradual të projektvendimit.

Lidhur me sugjerimin për hartimin e një plani kombëtar investimesh, sqarojmë se sugjerimi nuk është marrë në konsideratë, pasi projektvendimi ka karakter rregullator dhe synon miratimin e kritereve, procedurave dhe objektivave për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Hartimi i planeve kombëtare të investimit nuk janë objekt i këtij vendimi dhe trajtohen me akte të tjera.

Lidhur me sugjerimin për krijimin e një mekanizmi financiar mbështetës për bashkitë, sqarojmë se projektvendimi nuk ka si objekt parashikimin apo miratimin e mekanizmave financiar mbështetës për bashkitë.

Lidhur me sugjerimin për funksionalizimin e impianteve rajonale përpara vendosjes së detyrimeve, sqarojmë se detyrimi i ndarjes në burim dhe

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e kritereve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve"

grumbullimi i diferencuar i mbetjeve është pikë kyçe për funksionimin efektiv të impianteve të trajtimit dhe arritjen e objektivave të përcaktuara. Në këtë kuptim, grumbullimi i diferencuar dhe trajtimi konsiderohen procese plotësuese dhe të ndërlidhura, jo të njëpasnjëshme.

Lidhur me sugjerimin për forcimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale, sqarojmë se projektvendimi nuk ka si objekt forcimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale. Çështjet që lidhen me forcimin e këtyre kapaciteteve përbëjnë përgjegjësi të vetë bashkisë, e cila në funksion të kompetencave të saj ndërmerr iniciativat e nevojshme për rritjen e kapaciteteve teknike dhe administrative.

Lidhur me sugjerimin për fushata kombëtare ndërgjegjësimi, sqarojmë fushata kombëtare ndërgjegjësimi janë kryer nga Ministria e Mjedisit, vazhdojnë të kryhen nga Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, si dhe nga organizata të ndryshme si GIZ etj.

Lidhur me sugjerimin për mekanizmat e qarta të monitorimit dhe raportimit, sqarojmë se në projektvendimin e ripunuar janë hequr procedurat e raportimit, duke qenë se në bazë të autorizimit ligjor të projektvendimit parashikohen vetëm procedurat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Mekanizmat e raportimit janë parashikuar në legjislacionin e posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Bashkia Librazhd është shprehur si më poshtë vijon:

Lidhur me sugjerimin për rishikimin e afateve dhe vendosja e fazave tranzitore, sqarojmë se është rishikuar rishikuar kreu IV, ku janë vendosur afatet për të gjitha rrymat e mbetjeve, në përputhje me kërkesat dhe standardet evropiane, si dhe periudhat tranzitore të kërkuara nga qeveria shqiptare, në mënyrë të tillë që të mundësojnë zbatim gradual të projektvendimit.

Lidhur me sugjerimin për hartimin e një plani kombëtar investimesh, sqarojmë se sugjerimi nuk është marrë në konsideratë, pasi projektvendimi ka karakter rregullator dhe synon miratimin e kriterëve, procedurave dhe objektivave për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Hartimi i planeve kombëtare të investimit nuk janë objekt i këtij vendimi dhe trajtohen me akte të tjera.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

Lidhur me sugjerimin për krijimin e një mekanizmi financiar mbështetës për bashkitë, sqarojmë se projektvendimi nuk ka si objekt parashikimin apo miratimin e mekanizmave financiar mbështetës për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Lidhur me sugjerimin për funksionalizimin e impianteve rajonale përpara vendosjes së detyrimeve, sqarojmë se detyrimi i ndarjes në burim dhe grumbullimi i diferencuar i mbetjeve është pikë kyçe për funksionimin efektiv të impianteve të trajtimit dhe arritjen e objektivave të përcaktuara. Në këtë kuptim, grumbullimi i diferencuar dhe zhvillimi i trajtimit konsiderohen procese plotësuese dhe të ndërlidhura, jo të njëpasnjëshme.

Lidhur me sugjerimin për forcimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale, sqarojmë se projektvendimi nuk ka si objekt forcimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale. Çështjet që lidhen me forcimin e këtyre kapaciteteve përbëjnë përgjegjësi të vetë njërive të vetëqeverisjes vendore, e cila në funksion të kompetencave të saj ndërmerr iniciativat e nevojshme për rritjen e kapaciteteve teknike dhe administrative.

Lidhur me sugjerimin për fushata kombëtare ndërgjegjësimi, sqarojmë se në projektvendimin e rishikuar është shtuar pika 5, në kreun III.

Lidhur me sugjerimin për mekanizmat e qarta të monitorimit dhe raportimit, sqarojmë se në projektvendimin e ripunuar janë hequr procedurat e raportimit, duke qenë se në bazë të autorizimit ligjor të projektvendimit parashikohen vetëm procedurat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Mekanizmat e raportimit janë parashikuar në legjislacionin e posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Bashkia Dibër është shprehur si më poshtë vijon:

Lidhur me sugjerimin që në projektvendim të shtohet një listë e qartë e rrymave kryesore të mbetjeve që do të trajtohen (plastikë, letër/karton, qelq, metal, biombetje, mbetje të rrezikshme nga amvisëritë, etj.), sqarojmë se projektvendimi është rishikuar plotësisht, duke shtuar kriteret, procedurat dhe afatet për të gjitha rrymat e mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që afatet të paraqiten në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar, mundësisht në formë tabele, duke përcaktuar objektiva konkrete sipas kategorive të mbetjeve dhe viteve të zbatimit, sqarojmë se afatet për grumbullimin e diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve janë parashikuar në pikën 2, të kreut IV.

Lidhur me sugjerimin që të shtohet një dispozitë që parashikon mundësinë e mbështetjes financiare dhe teknike nga fondet e BE-së, donatorët ndërkombëtarë dhe partneritetet publike-private, sqarojmë se projektvendimi nuk ka si objekt parashikimin mekanizmave financiar dhe teknike mbështetës për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Lidhur me sugjerimin që të përcaktohen indikatorë të matshëm për monitorimin e zbatimit (p.sh. përqindja e mbetjeve të ricikluara, numri i raporteve vjetore nga bashkitë, inspektimet e kryera), si dhe detyrimi për raportim periodik nga njësitë vendore, sqarojmë sqarojmë se në projektvendimin e ripunuar janë hequr procedurat e raportimit, duke qenë se në bazë të autorizimit ligjor të projektvendimit parashikohen vetëm procedurat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që projektvendimi të parashikojë detyrimisht fushata informimi dhe edukimi për qytetarët, në mënyrë që ndarja në burim të kuptohet si praktikë e dobishme dhe jo vetëm si detyrim ligjor, sqarojmë se është parashikuar në pikën 5, të kreut III.

Lidhur me sugjerimin që të shtohet një referencë për krijimin e qendrave lokale të riciklimit dhe mbështetjen e bizneseve që përdorin materiale të ricikluara, duke nxitur zhvillimin e sektorit dhe krijimin e vendeve të reja të punës, sqarojmë se është parashikuar që mbetjet të grumbullohen në mënyrë të diferencuar në pikat grumbullimi të përcaktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ose të ngritura nga operatorët e licencuar.

Bashkia Pustec është shprehur si më poshtë vijon:

Lidhur me sugjerimin për mbështetje financiare, sqarojmë se projektvendimi nuk ka si objekt parashikimin apo miratimin e mekanizmave financiar mbështetës për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

Lidhur me sugjerimin për furnizimin me kosha të diferencuar për fraksione të ndryshme (plastikë, letër, metal, qelq, organike), sqarojmë se projektvendimi nuk ka si objekt parashikimin për furnizim me kosha të diferencuar.

Lidhur me sugjerimin për trajnime dhe fushata sensibilizuese për komunitetin nëpërmjet seminareve dhe broshurave informuese dhe sensibilizuese për komunitetin, sqarojmë se në pikën 5, të kreut III është parashikuar se njësitë e vetëqeverisjes vendore organizojnë fushata informimi dhe ndërgjegjësimi.

Lidhur me sugjerimin për mbështetje teknike dhe financiare për hartimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve, sqarojmë se projektvendimi nuk ka si objekt parashikimin mekanizmave financiar dhe teknike mbështetës për njësitë e vetëqeverisjes vendore për hartimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin për përshtatje të afateve për bashkitë me kapacitet të kufizuar, sqarojmë se afatet janë të njëjta për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, pasi janë në përputhje me kërkesat dhe standardet evropiane, si dhe periudhat tranzitore të kërkuara nga qeveria shqiptare, në mënyrë të tillë që të mundësojnë zbatim gradual të projektvendimit

Bashkia Dropull është shprehur si më poshtë vijon:

Lidhur me sugjerimin që projektvendimi të parashikojë faza të qarta dhe të shkallëzuara edukimi dhe ndërgjegjësimi përpara vendosjes së detyrimeve të plota për zbatim, sqarojmë se se nuk është objekt i këtij projektvendimi parashikimi i fazave të edukimit dhe ndërgjegjësimi.

Lidhur me sugjerimin që zbatimi i projektvendimit të realizohet në mënyrë graduale dhe të diferencuar, duke marrë në konsideratë kapacitetet financiare, infrastrukurore dhe njerëzore të bashkive të vogla dhe rurale, si dhe të parashikojë mekanizma konkretë mbështetës, sqarojmë se afatet për përcaktimin dhe ngritjeve të pikave të riciklimit, si dhe afatet për zbatimin e kriterëve dhe procedurave për grumbullimin e diferencuar, janë parashikuar në kreun IV, të këtij projektvendimi. Sa i përket mekanizmave mbështetës, sqarojmë se se nuk është objekt i këtij projektvendimi.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve"

Projektvendimi u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me atë të Vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, të cilët janë shprehur si vijon:

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit shprehet parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u shpreh parimisht dakord me projektvendimin.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë u shpreh parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor shprehet parimisht dakord me projektvendimin.

Ministri i Shteti dhe Kryenegociator shprehet parimisht dakord me projektvendimin.

Ministria e Financave shprehet si vijon:

Lidhur me kërkesën që në relacionin shpjegues të projektvendimit të përcaktohet nëse vendosja e këtyre detyrimeve do të sjellë kosto potenciale shtesë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, si dhe cilat janë kapacitetet e tyre për t'i përballuar këto kosto brenda buxheteve përkatëse sqarojmë se bazuar në direktivën 2008/98/KE “Mbi mbetjet dhe shfuqizimin e disa direktivave”, të amenduar sipas DSIP për zbatimin e Direktivës, vlerësimi financiar i grumbullimit të diferencuar duhet të mbështetet në parimin e mbulimit të kostove dhe në ndarjen e qartë të përgjegjësisë financiare ndërmjet tarifave publike dhe skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. DSIP vlerëson se kostot totale vjetore të sistemit të menaxhimit të mbetjeve bashkiake do të rriten nga 71.6 milionë euro në vitin 2025 në 168.9 milionë euro në vitin 2035, ndërsa rreth 17% e kostove totale

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kritereve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

vjetore në vitin 2035, ose rreth 28.4 milionë euro, lidhen drejtpërdrejt me grumbullimin e diferencuar dhe ndarjen e mbetjeve të riciklueshme.

Duke qenë se pjesa më e madhe e këtyre fraksioneve përbëhet nga mbetje ambalazhi, DSIP parashikon që këto kosto të mbulohen kryesisht nga skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe të mos përfshihen në tarifën e zakonshme të shërbimit të mbetjeve që paguhet nga familjet dhe subjektet (operatorët).

Në këtë mënyrë, financimi i grumbullimit të diferencuar lidhet drejtpërdrejt me parimin “ndotësi paguan” dhe me kërkesat e direktivës 2008/98/KE për përgjegjësinë financiare të prodhuesve, ndërsa tarifën bashkiake dhe transfertat nga buxhetet vendore mbulojnë kostot e tjera të shërbimit publik të menaxhimit të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që të korrigohet referenca për mbetjet bashkiake, sqarojmë se projektvendimi është ripunuar bazuar autorizimit ligjor duke përfshirë të gjitha rrymat e mbetjeve.

Ministria e Drejtësisë shprehet si vijon:

Lidhur me rekomandimin që projektakti të ripunohet me qëllim ezaurimin e plotë të dispozitës autorizuese të ligjit, në mënyrë që të mundësohet përcaktimi i të gjitha kriterëve, procedurave dhe afateve për të gjitha rrymat e mbetjeve dhe jo vetëm për një kategori të caktuar, sqarojmë se projektvendimi është ripunuar tërësisht në përputhje me autorizimin ligjor, duke garantuar transpozimin dhe zbatimin e plotë të tij. Në këtë kuadër, në projektvendim janë përcaktuar në mënyrë të detajuar dhe të integruar kriteret, procedurat dhe afatet për grumbullimin e diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve, në përputhje me pikën 2 të nenit 11 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Njëkohësisht, në pikën 5 të nenit 47 të këtij ligji parashikohet miratimi, me vendim të Këshillit të Ministrave, i rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura, duke përfshirë ndër të tjera kërkesa teknike, instrumente ekonomike dhe marrëveshje vullnetare. Në analizë të këtij autorizimi të posaçëm, është vlerësuar se përmbajtja e tij është në lidhje të drejtpërdrejtë dhe funksionale me objektin e projektvendimit në fjalë, i cili rregullon në mënyrë të përgjithshme grumbullimin e diferencuar të rrymave të mbetjeve.

Në këto kushte, duke marrë në konsideratë se rregullimi i këtyre çështjeve në një akt të vetëm garanton trajtim të njëjtë dhe të qëndrueshëm të rrymave të mbetjeve, është vlerësuar e arsyeshme që rregullat përkatëse për rrymën e vajrave të përdorura të përfshihen në këtë projektvendim. Për këtë qëllim, janë parashikuar kritere, procedura specifike dhe afate të dedikuara për këtë rrymë mbetjesh, në përputhje me kërkesat e nenit 47 të ligjit.

Lidhur me sugjerimin që projektvendimi duhet të shmangë çdo mbivendosje apo kundërshtim në dispozitat e tij, ku si shembull sjellim në vëmendjen tuaj harmonizimin e pikave 2 dhe 3 të Kreut I me pikën 2 të Kreut II të projektaktit, sqarojmë se projektvendimi është ripunuar duke shmangur çdo mbivendosje, apo kundërshtim me pikat e tij. Konkretisht pikat 2 dhe 3, të Kreut I të draftit të parë të projektvendimit, janë hequr nga projektvendimi i ripunuar dhe është përcaktuar objekti i projektvendimit, i cili ka për qëllim miratimin e kritereve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbetjet, si dhe janë shtuar pikat 2 dhe 3 në Kreun I në harmonizim me objektin e projektvendimit dhe me dispozitat e tjera të aktit. Konkretisht, është saktësuar detyrimi për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve nga zotëruesit e tyre, duke theksuar parandalimin e përzierjes së rrymave të mbetjeve dhe minimizimin e ndikimeve negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, si dhe është parashikuar zbatimi i parimeve themelore, si hierarkia e mbetjeve, ekonomia qarkulluese dhe parimi “ndotësi paguan.

Lidhur me sugjerimin se në dispozitën autorizuese të projektaktit ku parashikohet se Këshilli i Ministrave miraton vendimin pas konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, në relacionin shoqërues duhet të pasqyrohet konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për rregullat e trajtimit të mbetjeve, Ju bëjmë me dije se projektvendimi është dërguar në rrugë elektronike në datë 8.02.2026, për konsultim paraprak në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe komentet/sugjerimet për projektvendimin të përcjella nga njësitë e vetëqeverisjes vendore janë pasqyruar në relacionin shoqërues të detajuara për secilën bashki. Gjithashtu, Ju informojmë se më datë 24 mars 2026, u zhvillua një workshop konsultues me forumin e shoqatës së bashkive, në të cilin u diskutua përmbajtja e projektvendimit dhe u përcollën komente dhe sugjerime nëpërmjet faqes zyrtare të konsultimit publik, të cilat janë reflektuar më poshtë.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kritereve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

Lidhur me sugjerimin që në relacionin shoqërues të projektaktit të pasqyrohen kriteret, për aq sa është e mundur, mbi bazën e të cilëve janë vendosur afatet për trajtimin e mbetjeve në Kreun IV, sqarojmë se kriteret në projektvendimin e hartuar janë parashikuar në mënyrë të përgjithshme dhe në paragrafin pasues në mënyrë specifike për secilën rrymë të mbetjeve, të shpjguara po ashtu në relacionin shoqërues, ndërkohë që afatet janë përcaktuar konform kërkesave dhe standardeve evropiane, si dhe periudhat tranzitore të kërkuara nga qeveria shqiptare, në mënyrë të tillë që të mundësojnë zbatim gradual të projektvendimit.

Këshilli konsultativ është shprehur si vijon:

Lidhur me sugjerimin që të sigurohet një ndarje e qartë e përgjegjësive dhe një mekanizëm efektiv koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse, si dhe të shoqërohet me mekanizma të qartë koordinimi ndërinstitucional, sqarojmë se janë qartësuar dhe përcaktuar rolet për zotëruesit e mbetjeve, bashkisë dhe operatorit të licencuar në procedurën e parashikuar për secilën rrymë mbetjesh.

Lidhur me sugjerimin që të shoqërohet akti me: një plan kombëtar për mbështetjen e bashkive në investimet infrastrukturore, programe trajnimi për administratën vendore, programe ndërgjegjësimi për qytetarët dhe bizneset, si dhe udhëzime teknike standarde për organizimin e grumbullimit të diferencuar, sqarojmë se nuk janë objekt i këtij vendimi dhe autorizimi ligjor përcakton miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për të gjitha rrymat e mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që të krijohen mekanizma mbështetjeje financiare për bashkitë ndërkohë që implementimi i këtij sistemi do të kërkojë investime të konsiderueshme sqarojmë se projektvendimi nuk ka si objekt parashikimin mekanizmave financiar për bashkitë.

Lidhur me sugjerimin që të qartësohet roli i AKEM si institucion mbështetës dhe zhvillues i tregut të riciklimit më mirë në raport me bashkitë dhe institucionet e tjera publike, sqarojmë se është parashikuar në legjislacionin e posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Nëpërmjet portalit të konsultimit publik janë paraqitur komentet si vijon:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

Lidhur me sugjerimin se vendimi është përafuar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”, e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva por, Referuar Directive (EU) 2018/851 of the European Parliament and of the Council of 30 May 2018 amending Directive 2008/98/EC on Ëaste, konstatohet që projektakti nuk është përmbajtur sipas afateve të Direktivës së sipërcituar, në të cilët Shqipëria është bërë pjesë e negociatave të BE. Për këtë kërkohet të rishikohen detyrimet dhe mënyrën e parandalimit, trajtimit, grumbullimit, ndarjen e mbetjeve në burim dhe mënyrën e zbatimit të projektvendimit, sqarojmë se sugjerimi nuk u mor në konsideratë, pasi afatet e projektvendimit janë konform afateve të direktivës 2008/98/KE “Mbi mbetjet dhe shfuqizimin e disa direktivave”, të amenduar, si dhe rregulloren (BE) 2025/40 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbi paketimin dhe mbetjet nga paketimi”.

Lidhur me sugjerimin se në projektvendim nuk është përcaktuar forma e ndarjes së mbetjeve në burim sipas rrymave (2 – 3 apo 4 rryma) dhe si e tillë nuk jepet qartësimi sesa kontenierë duhet të jetë ndarja e mbetjeve në 61 Bashktë.

Kërkohet që në projektaktin të saktësohet mënyrat e rrymave të mbetjeve dhe kontenierëve sipas ngjyrave si:

- a. Mbetje organike (kafe);
- b. Mbetje të plastikës dhe qelqit (verdhë/jeshile);
- c. Mbetje metalike (Kuçe);
- d. Mbetje letër dhe karton (blu);

Sqarojmë se sugjerimi për ndarjen e mbetjeve në burim u mor në konsideratë dhe është reflektuar në Shtojcën 1 të projektvendimit.

Lidhur me sugjerimin se pika 5 duhet riparë, pasi në fushën e grumbullimit, transportimit, trajtimit, riciklimit deri në vëndin e asgjësimit e miratuar nga institucionet përgjegjëse, operatorët duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore në përputhje me shtojcën 1, si dhe licencë të Tipit III/2.B dhe nuk duhet të lihet evazivë kjo pikë, sqarojmë janë hequr procedurat e raportimit, duke qenë se në bazë të autorizimit ligjor të projektvendimit parashikohen vetëm procedurat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Mekanizmat e raportimit janë parashikuar në legjislacionin e posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin se projektvendimi duhet të jepet formati, që do të përdoret për përcaktimin e kërkesave për llogaritjen e objektivave dhe hartimin e raportit,

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

të parashikuar në pikën 1 të Kreut IV, si dhe duhet të ketë edhe Shtojcë 1 për Formatin e raportimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të përcaktuar me kodet sipas katalogut të mbetjeve, e cila mungon në këtë projektvendim, sqarojmë se sugjerimi për përcaktimin e kërkesave për llogaritjen e objektivave dhe hartimin e raportit nuk u mor në konsideratë, pasi nuk është objekt i këtij vendimi.

Lidhur me sugjerimin se në pikën 1, të Kreut IV për afatet për grumbullimin e diferencuar, duhet të ketë rikonceptim dhe një detyrim për Njësitë e vetëqeverisjes vendore si:

Njësitë e qeverisjes vendore duhet të marrin masat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim brenda datës 31 Dhjetor 2028, duke u siguruar qytetarëve minimalisht një sistem grumbullimi mbetjesh prej 3 rryma mbetje, pasi bazuar në:

- Ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 25.6.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” si dhe
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 27.5.2020, “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035” afati për ndarjen në 3 rryma është 31 Dhjetor 2018.

Koha për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe njohjen e legjislacionit në fushën e mbetjeve në 61 Bashkitë ka kaluar çdo limit.

Në drejtim të afateve kohore të përcaktuar sipas % të rrymave të mbetjeve, konstatohet që ka një tolerancë shumë e madhe të viteve për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Për këtë duhet riparë dhe afati prej 65% duhet të jetë deri në vitin 2030, sqarojmë se sugjerimi nuk u mor në konsideratë, pasi afatet e projektvendimit janë konform kërkesave dhe standardet evropiane, si dhe periudhat tranzitore të kërkuara nga qeveria shqiptare, në mënyrë të tillë që të mundësojnë zbatim gradual të projektvendimit.

Lidhur me sugjerimin se Bazuar hartimi i raportit vjetor të mbetjeve duhet të jetë deri më 31 Mars të çdo viti dhe jo 31 Maj i çdo viti pasi ka një tolerancë shumë të madhe kohore për hartimin e këtij raporti. Duke marr shkas që raportimet po kalojnë on-linë edhe hedhja dhe raportimi mundëson zvoglimin e afateve kohore, sqarojmë janë hequr procedurat e raportimit, duke qenë se në bazë të autorizimit ligjor të projektvendimit parashikohen vetëm procedurat për grumbullimin e

diferencuar të mbetjeve. Mekanizmat e raportimit janë parashikuar në legjislacionin e posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin se në Kreun III, të shtohet edhe pika 8 ku citon se raporti i menaxhimit të mbetjeve të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe bëhet I disponueshëm për publikun, sqarojmë se ky parashikim specifikohet në legjislacionin e posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë është shprehur si më poshtë vijon:

Lidhur me sugjerimin që të parashikohet një fazë tranzitore për zbatimin e projektvendimit, duke marrë në konsideratë kapacitetet reale të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe detyrimet ekzistuese kontraktuale, sqarojmë se afatet për përcaktimin dhe ngritjen e pikave të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, si dhe zbatimin e kriterëve dhe procedurave për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve janë parashikuar në kreun IV.

Lidhur me sugjerimin që zbatimi të realizohet në mënyrë të fazuar, duke filluar me zona pilot dhe duke u shtrirë gradualisht në të gjithë territorin, sqarojmë se ky vendim i përket njësisë së qeverisjes vendore, për aq kohë sa zbatohen afatet dhe objektivat e parashikuara në projektvendim.

Lidhur me sugjerimin që të rishikohen afatet aktuale për arritjen e objektivave të riciklimit dhe ripërdorimit, duke i bërë ato më realiste dhe të arritshme, sqarojmë se afatet e përcaktuara janë në përputhje me kërkesat dhe standardet evropiane, si dhe periudhat tranzitore të kërkuara nga qeveria shqiptare, në mënyrë të tillë që të mundësojnë zbatim gradual të projektvendimit.

Lidhur me sugjerimin që të përcaktohen targete progresive dhe të fazuara në kohë, në përputhje me nivelin aktual të zhvillimit të sistemit në bashki, sqarojmë se janë parashikuar afatet në kreun IV.

Lidhur me sugjerimin që të merret në konsideratë konteksti buxhetor dhe institucional i bashkive, si dhe ndikimi i cikleve elektorale në vendimmarrje,

sqarojmë se është marrë në konsideratë konteksti buxhetor dhe institucional i bashkive, ndaj është parashikuar faza tranzitore për zbatimin e projektvendimit.

Lidhur me sugjerimin që të kryhet një vlerësim i plotë dhe realist i kostove të zbatimit, përfshirë investimet në infrastrukturë, kostot operative të shërbimit dhe kostot e trajtimit dhe riciklimit, sqarojmë se kostot janë parashikuar më sipër, në reflektim edhe të sugjerimit të Ministrisë së Financës.

Lidhur me sugjerimin që të parashikohen mekanizma të qartë financiare mbështetës për njësitë vendore, përfshirë krijimin e një fondi specifik nga qeveria qendrore dhe mobilizimin e fondeve të donatorëve dhe të qartësohen instrumentet dhe incentivat financiare që mundësojnë zbatimin e skemës, si dhe ndikimi në politikat fiskale vendore, sqarojmë se sugjerimi nuk u mor në konsideratë, pasi projektvendimi ka për objekt miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që të përcaktohet një model minimal i detyrueshëm për organizimin e grumbullimit të diferencuar, duke përfshirë: rrymat kryesore të mbetjeve dhe elementët bazë të funksionimit të sistemit, sqarojmë se janë parashikuar në kreun III, të projektvendimit.

Lidhur me sugjerimin që të vendoset një kod i unifikuar kombëtar i ngjyrave për kontejnerët sipas rrymave të mbetjeve, për të lehtësuar zbatimin dhe ndërgjegjësimin publik, sqarojmë se sugjerimi është marrë në konsideratë dhe është parashikuar në Shtojcën 1, të projektvendimit.

Lidhur me sugjerimin që të qartësohen dhe standardizohen procedurat e raportimit të të dhënave mbi mbetjet e grumbulluara në mënyrë të diferencuar, sqarojmë se sugjerimi u mor në konsideratë dhe u reflektua në projektvendim në kreun III.

Lidhur me sugjerimin që të harmonizohet kuadri ekzistues (AKEM/AKM) me legjislacionin e ri, duke shmangur mbivendosjet dhe paqartësitë institucionale, sqarojmë se sugjerimi u mor në konsideratë dhe janë shmangur mbivendosjet dhe paqartësitë institucionale.

Lidhur me sugjerimin që të përcaktohen qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe të krijohet një bazë të dhënash e strukturuar për operatorët e riciklimit dhe

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

subjektet e sektorit, sqarojmë se në projektvendimin e ripunuar janë hequr procedurat e raportimit, duke qenë se në bazë të autorizimit ligjor të projektvendimit parashikohen vetëm procedurat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Mekanizmat e raportimit janë parashikuar në legjislacionin e posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që të qartësohen detyrimet e raportimit për bizneset, duke specifikuar kategoritë dhe procedurat e zbatimit, sqarojmë se në projektvendimin e ripunuar janë hequr procedurat e raportimit, duke qenë se në bazë të autorizimit ligjor të projektvendimit parashikohen vetëm procedurat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që të garantohet funksionimi i plotë i zinxhirit të menaxhimit të mbetjeve, duke lidhur detyrimisht grumbullimin e diferencuar me sistemet e trajtimit dhe riciklimit, sqarojmë se është përfshirë në kreun III për procedurat e mbetjeve.

Lidhur me sugjerimin që të forcohet lidhja e projektvendimit me ligjin për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit, të qartësohet roli i organizatave të përgjegjësisë së prodhuesve (SHPZP) në: financimin e sistemit, organizimin e grumbullimit, dhe arritjen e targeteve të riciklimit, si dhe të specifikohet bashkëpunimi ndërmjet bashkive dhe këtyre strukturave, sqarojmë se janë përfshirë operatorët e licencuar në këtë projektvendim, megjithatë detajet e mëtejshme do të parashikohen me akte nënligjore të posaçme.

Lidhur me sugjerimin që të parashikohen fonde dhe mekanizma për zhvillimin e fushatave të vazhdueshme ndërgjegjësuere dhe të sigurohet një qasje e koordinuar në nivel kombëtar për edukimin e qytetarëve dhe bizneseve, sqarojmë se sugjerimi nuk u mor në konsideratë, pasi nuk është objekt i këtij projektvendimi.

Projektvendimi i ripunuar do dërgohet për bashkërendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me atë të Vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk parashikon të sjellë kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTËR

Sofjan JAUPAJ

